



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA V Lorë  
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 9611 prot.

Vlorë, më 19.06 2024

**PROJEKT -VENDIM**

**PËR**

**MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA  
DJEGIA E BANESËS TË Z.ËNGJËLL KOLILA DHE SHPËRBLIMIN  
FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË V Lorë.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë dhe pika 3/a, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z.Ëngjëll Kolila, e ndodhur në lagjen “Kushtrimi”, Rajoni Nr.5, Bashkia Vlorë, në datën 04.02.2024, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

A. 73.528 (shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet e shtatë) lekë për punime ndërtimi (147.051x50%).

B. 167.507 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e shtatë) lekë për mobilje dhe pajisje elektorshtëpiake.

- Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të Bashkisë Vlorë.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, neni 55 pika .

**KRYETAR**  
**Ermal Dredha**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 9611 prot.

Vlorë, më 19.06 2024

**RELACION**

**PËR**

**PROJEKT-VENDIMIN “MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA NË BANESËN E Z.ËNGJËLL KOLILA DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË “**

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, në Bashkinë Vlorë date 23.02.2024 ka paraqitur kërkesën z.Engjëll Kolila me nr prot2902 për shkakë të djegies së banesës e ndodhur në lagjen “Kushtrim” Rajoni 5 Bashkia Vlorë.

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.15 datë 12.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë ,shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

Mbas hartimit të proces-verbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 01.03.2024, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.2902/1 prot, datë 17.04.2024 “Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të z.Ëngjëll Kolila” në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.8898 prot, datë 06.06.2024 “Dërgim dokumentacioni për banesën e djegur të z.Ëngjëll Kolila” ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve në banesën e z.Ëngjëll Kolila është 241.032 (dyqind e dyzetë e një mijë e tridhjetë e dy) lekë.

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjet për banesat e djegura.

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesat e z.Ëngjëll Kolila sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.

**DREJTOR**

**Adrian Vreshtazi**

